

Instituti i Modelimeve në Biznes sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakët e Shoqërisë Instituti i Modelimeve në Biznes sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Instituti i Modelimeve në Biznes sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Teit Gjini
Auditues Ligjor

18 mars 2017



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al . info@ mazars.al

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	26,682,924	63,062,994
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	28,660,986	17,917,339
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	496,833	362,972
Parapagime e shpenzime të shtyra	7	2,945,828	-
Inventarë	8	433,452	313,123
Totali i aktiveve afatshkurtra		59,220,023	81,656,428
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	14,834,551	11,531,269
Aktive afatgjatë jomateriale	10	1,211,114	1,541,417
Totali i aktiveve afatgjatë		16,045,665	13,072,686
Totali i aktiveve		75,265,688	94,729,114
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	2,821,576	5,161,327
Detyrime tatimore	12	7,339,784	13,934,615
Të ardhurat e shtyra	13	18,215,054	20,281,131
Parapagime të marra	14	-	403,625
Totali i detyrimeve afatshkurtra		28,376,414	39,780,698
Detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		28,376,414	39,780,698
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		8,903,000	8,903,000
Rezerva ligjore		1,224,000	1,224,000
Rezerva statutore		200,000	200,000
Fitimi i ushtrimit		36,562,274	44,621,416
Totali i kapitalit	15	46,889,274	54,948,416
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		75,265,688	94,729,114

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	150,369,427	173,800,631
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(487,627)	(314,061)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(21,761,586)	(40,907,861)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të			
1) tjera	18	(10,715,616)	(27,794,914)
2) Të tjera shpenzime	19	(11,045,970)	(13,112,947)
Shpenzime të personelit	20	(81,692,040)	(77,301,722)
1) Paga dhe shpërblime		(72,931,022)	(71,180,745)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(8,761,018)	(6,120,977)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9,10	(3,315,599)	(2,509,025)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(850)	(30,000)
Zhvlërësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra	22	-	71,448
Shpenzime financiare	23	41	6,145
Shpenzime interesi dhe			
1) shpenzime të ngjashme		41	6,145
2) Shpenzime të tjera financiare		-	-
Fitimi/humbja para tatimit		43,111,766	52,815,555
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(6,549,492)	(8,194,139)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin	24	(6,549,492)	(8,194,139)
Fitimi/humbja e vitit		36,562,274	44,621,416
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		36,562,274	44,621,416

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2015	8,903,000	1,424,000	7,794,414	18,121,414
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin: Dividendë të paguar			44,621,416 (7,794,414)	44,621,416 (7,794,414)
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	8,903,000	1,424,000	44,621,416	54,948,416
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin: Dividendë të paguar			36,562,274 (44,621,416)	36,562,274 (44,621,416)
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	8,903,000	1,424,000	36,562,274	46,889,274

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Instituti i Modelimeve në Biznes sh.p.k më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:



[Signature]
Sagjest Ekonomik
Administrator

[Signature]
Luiza Korbi
Financiere

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	36,562,274	44,621,416
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	503,852	315,970
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	6,706,280
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	3,315,599	2,509,025
Krijimi/rimarrja e provizioneve	-	(71,448)
Humbje nga nxerrja nga përdorimi i AAM-ve	88,675	133,666
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(9,193)	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(13,823,336)	(9,552,694)
Rënie/(rritje) në inventarë	(120,329)	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(11,404,285)	8,031,670
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	15,113,257	52,693,885
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(6,762,227)	(3,745,288)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	394,168	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(6,368,059)	(3,745,288)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Dividendë të paguar	(44,621,416)	(7,794,414)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(44,621,416)	(7,794,414)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(35,876,218)	41,154,183
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	63,062,994	22,224,781
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(503,852)	(315,970)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	26,682,924	63,062,994

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Instituti i Modelimeve në Biznes shpk është krijuar në vitin 1997, me vendim gjykate Nr. 17769 datë 23/09/1997. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk është një shoqëri shqiptare me adresë të regjistruar në Bulevardin "Gjergj Fishta", P. Pallati Nr.4, Ap.42, 45, 47 dhe 2/2, Tiranë. Shoqëria ka NIPT K01410001N.

Ortakët e shoqërisë janë:

• Kelvin Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Kosta Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Sagest Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Maksi Raco	55% ose	4,896.65 pjesë të kapitalit.

Kapitali themeltar i regjistruar i shoqërisë paraqitet në vlerën 8,903,000 ALL.

Objekti i shoqërisë është në fushën informatike, import- export dhe shitje me shumicë e pakicë të pajisjeve informatike e elektronike të ndryshme.

Më 31 dhjetor 2016 shoqëria ka 71 punonjës (2015: 63).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
EURO/Lek	135.23	137.28
USD/ Lek	128.17	125.79

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

<u>Kategoria e aktiveve</u>	<u>Metoda e Amortizimit</u>	<u>Norma e Amortizimit</u>
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje zyre e informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës është më e vogël se 10 për qind e kostos historike të këtij aktiviteti, atëherë aktiviteti amortizohet plotësisht.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdoj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksat e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	25,270,459	60,733,659
Mjete monetare në arkë	1,412,465	2,329,335
	<u>26.682,924</u>	<u>63,062,994</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë për mallra, produkte e shërbime	28,660,986	17,917,339
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	-	-
	<u>28,660,986</u>	<u>17,917,339</u>
Gjendje më 1 janar	-	1,235,765
Shtesa	-	-
Pakësime	-	(1,235,765)
	<u>-</u>	<u>-</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	-	48,100
Parapagime	-	52,012
Tatimi mbi fitimin	8,582	-
Garanci	488,251	262,860
	<u>496,833</u>	<u>362,972</u>

7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime të shtyra	2,945,828	-
	<u>2,945,828</u>	<u>-</u>

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

8. Inventari

Shoqëria ka kryer inventarizimin e gjendjeve të inventarit në fund të vitit, rezultatet e të cilit përputhen me vlerën e stokut të pasqyruar në bilanc. Në mbyllje të vitit ushtrimor janë kryer llogaritjet e sakta për pasqyrimin në rezultatin e ushtrimit të efekteve të ndryshimit të gjendjeve të inventarit. Kontabilizimi i veprimeve me stokun kryhet konform normave kontabël.

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mallra	433,452	313,123
	<u>433,452</u>	<u>313,123</u>

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre e informatike	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>					
Gjendja më 1 janar 2015	2,908,277	3,891,147	8,123,806	10,208,155	25,131,385
Shtesa	592,568	-	1,734,764	1,417,956	3,745,288
Nxjerrje jashtë përdorimit	(1,114,554)	-	(366,280)	(1,145,553)	(2,626,387)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,386,291	3,891,147	9,492,290	10,480,558	26,250,286
Shtesa	162,020	3,331,440	1,921,822	1,346,945	6,762,227
Nxjerrje jashtë përdorimit	(24,583)	(1,438,547)	(828,893)	(233,974)	(2,525,997)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,523,728	5,784,040	10,585,219	11,593,529	30,486,516
<i>Zhvierësimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 1 janar 2015	2,163,600	2,201,118	4,677,269	5,991,030	15,033,017
Amortizimi i vitit	187,793	338,006	1,064,567	588,355	2,178,721
Nxjerrje jashtë përdorimit	(1,052,664)	-	(340,542)	(1,099,515)	(2,492,721)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,298,729	2,539,124	5,401,294	5,479,870	14,719,017
Amortizimi i vitit	239,204	692,117	1,312,740	741,235	2,985,296
Nxjerrje jashtë përdorimit	(21,214)	(1,122,645)	(699,805)	(208,684)	(2,052,348)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,516,719	2,108,596	6,014,229	6,012,421	15,651,965
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,087,562	1,352,023	4,090,996	5,000,688	11,531,269
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,007,009	3,675,444	4,570,990	5,581,108	14,834,551

10. Aktive afatgjata jomateriale

	AAJM
Me kosto	
Gjendja më 1 janar 2015	2,202,025
Shtesa	-
Transferime	-
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,202,025
Shtesa	-
Transferime	-
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,202,025
Amortizimi	
Gjendja më 1 janar 2015	330,304
Amortizimi i vitit	330,304
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	660,608
Amortizimi i vitit	330,303
Pakësime	-
Gjendja me 31 dhjetor 2016	990,911
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2015	1,541,417
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2016	1,211,114

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitorë	2,821,576	5,161,327
	2,821,576	5,161,327

Llogaritë e pagueshme tregtare pasqyrojnë detyrimet për blerjen e materialeve dhe shërbimeve. Shoqëria ka mbajtur evidencë analitike për çdo furnitor.

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Sigurimet shoqërore	1,271,011	1,108,305
Tatim në burim	117,881	322,351
Tatim mbi të ardhurat personale të punonjësve	2,167,120	5,757,370
Tatimi mbi fitimin	-	6,706,280
TVSH e pagueshme	3,783,772	40,309
	<u>7,339,784</u>	<u>13,934,615</u>

13. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura të shtyra	18,215,054	20,281,131
	<u>18,215,054</u>	<u>20,281,131</u>

14. Parapagime të marra

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime të marra	-	403,625
	<u>-</u>	<u>403,625</u>

15. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 8.903.000 Lek (8,903 kuota me 1,000 Lek vlere nominale).

	<u>31 dhjetor 2016</u>			<u>31 dhjetor 2015</u>		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Kelvin Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	1,335,450	15%
Kosta Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	1,335,450	15%
Sagest Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	1,335,450	15%
Maksi Raço	4,896.65	4,896,650	55%	4,896.65	4,896,650	55%
	<u>8,903.00</u>	<u>8,903,000</u>	<u>100%</u>	<u>8,903.00</u>	<u>8,903,000</u>	<u>100%</u>

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	55,220,676	68,903,593
Të ardhura nga shitja e produkteve	95,010,291	103,618,776
Të ardhura nga shitja e mallrave	138,460	1,278,262
	<u>150,369,427</u>	<u>173,800,631</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në		
Qarkullim i tatueshëm	149,554,307	193,534,504
Zbriten Autofaturimet	(1,260,414)	(1,689,465)
Zbriten paradhëniet	403,625	(403,625)
Shtohen të ardhurat e rimarra nga viti paraardhës	20,281,131	1,927,350
Zbriten të ardhura të shtyra për vitin tjetër	(18,215,054)	(20,281,131)
Shitje të 2014 që janë anuluar dhe deklaruar me minus në librat e vitit 2015	-	712,998
Zbritet vlera kontabël neto e AAM-ve të shitura		
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	(384,975)	-
Shtohen diferencat e këmbimit të përfshira në zërin Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	(496,820)	(314,061)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	<u>149,881,800</u>	<u>173,486,570</u>
Sipas Kontabilitetit	149,881,800	173,486,570
Diferenca	-	-

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura sipas kontabilitetit	<u>149,881,800</u>
Shtohen humbjet e këmbimit të përfshira në të ardhura të tjera	503,895
Të ardhura nga interesat përfshirë në të ardhura financiare	41
Të ardhura nga grantet paraqitur neto në shpenzime	-
Për tu deklaruar në FDP tatim fitimi	<u>150,385,736</u>

17. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Fitime nga këmbimet valutore	7,075	16,916
Humbje nga këmbimet valutore	(503,895)	(330,977)
	<u>(496,820)</u>	<u>(314,061)</u>
Të ardhura nga shitja e AAM	394,168	-
Shpenzime nga shitja e AAM	(384,975)	-
	<u>9,193</u>	<u>-</u>
	<u>(487,627)</u>	<u>(314,061)</u>

18. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Materiale të para	1,869,241	18,132,989
Mallra dhe programe	854,372	593,558
Shërbime	7,992,003	9,068,367
Blerje programesh	1,260,417	1,446,691
Energji elektrike e shpenzime komunikimi	4,296,708	4,359,981
Nëntrajtime e programe të tjera	899,501	510,163
Mirëmbajtje e riparime nga të tretë	741,260	387,301
Shërbime nga të tretë	794,117	1,945,642
Të tjera	-	418,589
	<u>10,715,616</u>	<u>27,794,914</u>

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Qira zyre	5,983,900	4,455,683
Taksa lokale e të tjera	131,774	57,773
Reklama	-	551,890
Transferime, udhëtime e dieta	671,617	1,212,928
Shërbime bankare	188,648	185,021
Dieta tej kufirit të lejuar	70,650	157,623
Shpenzime për pritje e përfaqësime	331,050	137,268
Shpenzime të panjohura	290,954	1,084,718
Blerje uji e materiale sanitare	680,928	710,367
AQT- jashtë përdorimit	88,675	133,665
Honorare	981,855	1,041,469
Shpenzime për certifikim ISO	-	516,667
Shpenzime të tjera	1,625,919	2,867,875
	11,045,970	13,112,947

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	72,931,022	71,180,745
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	8,761,018	6,120,977
	81,692,040	77,301,722

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 71 (2015: 63).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjoba dhe penalitete	850	30,000
	850	30,000

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

22. Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Zhvlerësim i kërkesave për arkëtim/(rimarrje)	-	(1,235,765)
Shpenzime borxh i keq	-	1,164,317
	-	(71,448)

23. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga interesi	41	6,145
	41	6,145

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<i>Fitimi para tatimit</i>	43,111,766	52,815,555
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	551,511	1,812,039
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	850	30,000
Shpenzime udhëtimi	70,650	157,623
Tatim i panjohur	189,057	254,415
Debitor të këqinj humbje nga mosarkëtimi	-	1,164,317
Provizion për zhvlerësime	-	(1,235,765)
Shpenzime të tjera	290,954	1,441,449
<i>Fitimi i tatueshem për periudhën</i>	<i>43,663,277</i>	<i>54,627,594</i>
<i>Norma e tatim fitimit (15%)</i>		
Shpenzime për tatim fitimin	6,549,492	8,194,139

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Tatim fitimi më 1 janar	(6,706,280)	(329,705)
Paguar detyrimi i vitit paraardhës	6,706,280	329,705
Parapagime tatim fitimi	6,558,074	1,487,859
Shpenzime tatim fitimi	(6,549,492)	(8,194,139)
Tatim fitimi i parapaguar/(për t'u paguar)	8,582	(6,706,280)

25. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Përfitimet e stafit drejtues	13,770,114	24,667,117
	<u>13,770,114</u>	<u>24,667,117</u>

Gjatë vitit janë shpërndarë dividend për shumën 44,621,416 Lek (2015: 7,794,414 Lek).

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

27. Angazhimet dhe pasiguritë

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

Mazars

Address

Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5

Tirane, Shqiperi

Tel. +355 (0) 42 278 015

audit@mazars.al

www.mazars.al